

VENDIM
Nr.281, datë 28.4.2010

**PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË PERSONAVE TË DËMTUAR NGA ZBATIMI I
PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS NËNTËVJEÇARE PUBLIKE NË LAGJEN
“MARK LULA”, BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 5.a dhe 5.b të pjesës C të ligjit nr.9603, datë 28.7.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim”, të ligjit nr.9661, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim”, të ligjit nr.9717, datë 19.4.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër të huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim”, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të z. Vuksan Vitaj, në vlerën 920 400 (nëntëqind e njëzet mijë e katërqind) lekë, për dëmin e shkaktuar mbi pronën e paluajtshme dhe të luajtshme (veprimtari ekonomike), si rezultat i zbatimit të projektit për ndërtimin e shkollës nëntëvjeçare publike në lagjen “Mark Lula”, bashkia Shkodër.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara, në buxhetin e vitit 2010, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha